

Ne fokus/ Ne Angli, bastet bejne Januzajn kuqezi

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 09 Tetor 2013 11:17



Adnan Januzaj do te zgjedhe Shqiperine. Keshtu parashikojne bastexhinjte ne te gjithë boten. Talenti shqiptar do te vendose shume shpejt por deri sa ai ta bej kete, njerez te ndryshem do te vendosin bast per te. Ne Angli ku vihet bast edhe per motin, kompanite e ndryshme kane hapur baste se ku do te luaj 18-vjeçari dhe padyshim qe Shqiperia eshte e kuotuar me koeficientin 1.36 dhe shihet si favorite per te marre djaloshin e arte. Kurre me pare, ne ndeshje te rralla Shqiperia mund te kete patur fatin te kuotohej me kete koeficient sikur dhe ne nje ndeshje me Andoren ne Tirane, ndersa pas kombetares tone sipas rradhes jane kuotuar Belgjika me 3.75, ndersa Turqia, Kroacia e Kosova me 11 dhe Anglia me 15.